

# Fotografia



# 7 inspirime për projekte me fotografi

Peter Holzwarth

Përdorimi i fotografisë është motivim për të rinjtë dhe mund të nxisë procese të shumta të të mësuarit: Ajo mundëson ta shohësh veten, botën tënde dhe të tjerët në një mënyrë tjetër, si dhe të mësosh për të komunikuar me imazhe. Fotografitë mund të përdoren edhe për të motivuar të shprehurit me gojë apo shkrim. Në botën e medias vizuale globale është me rëndësi të ketë qytetarë kreativë, kritikë dhe të edukuar vizuelisht.

## 1. Bota ime – perspektiva ime

Fotoaparati jepet për një ditë dhe fotografi bëjnë foto të gjërave që janë të rëndësishme në jetën e vet (vende të preferuara, persona, aspekte të rëndësishme në jetë, etj.). Pesë fotografitë më të rëndësishme shtypen dhe ngjiten në një fletë të madhe. Nën secilën fotografi, shtohen komente të shkurtra shpjeguese. Informacionet më të detajuara që jepen me fotografi mund të ndihmojnë mësuesit të kuptojnë më shumë për nxënësit dhe jetën e tyre.



„Klein, unordentlich, aber es ist mein Zimmer.  
Und es gefällt mir.“

„E vogël, e çrregullt, por është dhoma ime. Dhe unë e dua atë”



„Mein Lieblings Auto !!!“


“Makina ime e preferuar!!!”

(Shembull nga një projekt i medias me refugjatë.)


[https://www.ph-ludwigsburg.de/fileadmin/subsites/1b-mpxx-t-01/user\\_files/Online-Magazin/Ausgabe8/Ausstellung8.pdf](https://www.ph-ludwigsburg.de/fileadmin/subsites/1b-mpxx-t-01/user_files/Online-Magazin/Ausgabe8/Ausstellung8.pdf)

## 2. Pjesa më e mirë e imja (nga Wendy Ewald)

Fotografi i bën një foto pjesës më të mirë të vetes. Foto e shtypur kombinohet me një tekst të shkurtër për “pjesa më e mirë e imja”. Projektet u ndihmojnë të rinjve që të vlerësojnë trupin e tyre.



Flokët e mi janë si  
çokollatë e shijshme. Kaçurrelat e mia  
janë të fryra. Ndonjëherë janë të  
dredhura, e ndonjëherë të lagura.  
Flokët e mi, sa të bukur që janë. Në erë  
i shoh se si lëkunden. Oh, flokët e mi.



Gjunjët, gjunjët gjunjët!  
Të fortë si gorilla, më ndihmojnë të ec  
dhe janë të ngjitur me këmbët e mia.

[http://swellswoodburyhtselem.blogspot.ch/2015\\_04\\_01\\_archive.html](http://swellswoodburyhtselem.blogspot.ch/2015_04_01_archive.html)

<https://literacythroughphotography.wordpress.com/wendy-ewald/>

(Shembull nga një projekt shkollor).

### 3. Më pëlqen vetja sepse...

Një portret shtypet në letër dhe kombinohet me përfundimin e fjalisë “Më pëlqen vetja sepse...”. Projektet u ndihmojnë të rinjve të mendojnë pozitivisht për veten e tyre dhe ta komunikojnë këtë.



(Shembull nga një projekt shkollor)

### 4. Unë dhe sfondi im

Një portret me sfond të bardhë shtypet bardh e zi dhe një sfond tjetër mund të vizatohet. Çfarë tregon sfondi për një person? Sfondi mund të jetë mbështetje dhe mund të tregojë se çfarë do të donte të ishte dikush.



(Shembull nga një projekt shkollor)

## 5. Unë mund të fluturoj (Jan von Holleben)

Një person është i shtrirë në dysHEME duke bërë diçka të veçantë si duke mbajtur drejtpeshimin apo duke fluturuar. Fotografia bëhet nga një pozitë më e lartë (p.sh. mbi tavolinë, mur apo shkallë) prej së larti poshtë.



<http://www.janvonholleben.com>



(Maurer 2004, p. 187)

## 6. Të plotësuarit e fotografisë në të katër drejtimet (Holzwarth 2011, p. 28)

Kopja e një fotoje, apo vet fotoja (p.sh. një foto apo portret familjar) ngjitet në një fletë të madhe. Kuadri i fotos vazhdohet në të katër drejtimet përmes vizatimit.



(Shembull nga një projekt shkollor)

## 7. Perceptimi dhe të shprehurit e emocioneve

Pjesëmarrësit i bëjnë vetes fotografi duke shprehur emocionet themelore (p.sh. neutralitet, gëzim, trishtim, befasi, zemërim, neveri, frikë, etj). Në fund, një kolazh i ndjenjave të ndryshme është krijuar. Është po ashtu e mundur të krijohet një kolazh me të gjitha fytyrat e lumtura, me të gjitha fytyrat e trishtuara, me të gjitha fytyrat pyetëse, etj.



## Ide:

- Mësuesi mund të dojë t'i bëjë fotokopjet bardh e zi të fotografive që nxënësit i kanë sjellë që më parë (preferohet të jenë më të ndritshme).
- Mësuesi mund të dojë t'i bëjë portretet e të gjithë anëtarëve të klasës dhe t'i shtyp bardh e zi paraprakisht (preferohet të jenë më të ndritshme).
- Mësuesit mund të përdorin fotoaparatin edhe për ...
  - Dokumentimin e procesit të punës së fëmijëve;
  - Dokumentimin e produkteve finale të fëmijëve;
  - Mbledhjen e përshtypjeve për t'i informuar prindërit;
  - Mbledhjen e përshtypjeve për ueb faqe;
  - Bërjen e një fotografie të tërë klasës për të forcuar ndjenjën e përbashkimit.
- Ka projekte tjera fotografish në FACE 3, 1-5 (*Familja ime dhe unë*) dhe FACE 3, 3-5 (*fotografimi/vizatimi i vendit tim të preferuar*).
- Disa projekte të FACE mund të jenë projekte fotografish, po ashtu (për shembull "Ylli i aftësive të mia", me fotografinë në mes të yllit); FACE 2, 3-3 (*Ylli i aftësive të mia*)



## Referenca:

Holzwarth, Peter: Kreative Medienarbeit mit Fotografie, Video und Audio. Große und kleine Projektideen für die medienpädagogische Praxis. München: kopaed 2011

Maurer, Björn: Medienarbeit mit Kindern aus Migrationskontexten. Grundlagen und Praxisbausteine. München: kopaed 2004